

Një dekadë pas reformës - Demokratizimi dhe pavarësia e pushtetit vendor



Tetor 2025

Ky dokument u prodhua si pjesë e iniciativave publike të pjesëmarrësve të “Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike” dhe u mbështet nga Akademia e Studimeve Politike. Ofrimi i ekspertizës profesionale të këtyre hulumtimeve ndaj politikëbërësve synon të sigurojë një platformë diskutimesh për shkëmbimin e ndërsjelltë të ideve të reja.

Përgatiti:

Renaldo Salianji
Juljana Bilbilaj
Elvana Kurti

Hyrje

Qëllimi i këtij punimi është analiza e efekteve të reformës territoriale-administrative të vitit 2015 në Shqipëri, duke vlerësuar arritjet dhe kufizimet e saj në raport me autonominë vendore, pavarësinë dhe paanshmërinë politike, ofrimin e shërbimeve dhe demokratizimin e qeverisjes lokale, me fokus të veçantë në harmonizimin e praktikave të qeverisjes vendore me standardet e Bashkimit Evropian si një hap strategjik drejt integritit të plotë të Shqipërisë në BE.

Objektivat specifikë:

- Të identifikohen boshllëqet që kanë penguar realizimin e decentralizimit të plotë dhe përputhjen me kriteret e BE-së për qeverisjen vendore, sipas Raporteve të Komisionit Evropian dhe standardeve të Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore.
- Të përcaktohen përmirësime konkrete për rritjen e autonomisë financiare, pavarësisë, paanshmërisë politike, përfaqësimit qytetar dhe transparencës vendore, në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian dhe kërkesat për anëtarësim në BE.
- Propozimi i 3 rekomandime për një Reformë Territoriale të re (“Reforma 2.0”), që fuqizon demokracinë vendore dhe i përaftron institucionet dhe strukturën territoriale të Shqipërisë me kërkesat dhe standardet e Bashkimit Evropian, në funksion të integritit të plotë në BE.

I. Reforme Territoriale-Administrative 2015 në Shqipëri: Pavarësi Politike apo Motivim Elektorale?

Reforma Territoriale-Administrative e miratuar në Shqipëri në vitin 2014–2015 përbënte një nga transformimet më të rëndësishme të qeverisjes vendore. Duke reduktuar numrin e njësive të qeverisjes vendore nga 373 në 61 bashki të reja (Ligji 115/2014¹), në kuadër të strategjisë kombëtare të decentralizimit², reforma u paraqit si një domosdoshmëri për rritjen e kapaciteteve administrative, uljen e fragmentimit institucional dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike lokale. Megjithatë, që prej miratimit, në debatin publik dhe institucional ka dominuar një pyetje thelbësore: A ishte kjo reformë politikisht e pavarur, apo u dizajnuar me motive elektorale?

¹ https://prefektirane.gov.al/wp-content/uploads/2017/10/Ligj_115-2014_31.07.2014.pdf

² https://www.coe.int/en/web/congress/albania/-/asset_publisher/tkbUYO858az9/content/the-role-of-local-government-authorities-in-the-decentralisation-reform-process-in-albania?

Reforma u mbështet në objektiva të përputhura me Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore: autonomi lokale, eficiencë administrative dhe pjesëmarrje demokratike (CoE, 1985)³. Ligji 115/2014⁴ u miratua si instrument i ristrukturimit territorial, me arsyetimin se fragmentimi me 373 njësi ishte joefikas, i kushtueshëm dhe me mungesë kapacitetesh. Korniza u plotësua nga Ligji 139/2015⁵ për vetëqeverisjen vendore dhe Ligji 68/2017⁶ për financat vendore, duke krijuar bazën për përafrim me standardet e BE-së (KE, 2016; KE, 2017).

Sipas raportit të Kongresit të autoriteteve vendore të Congress of Local and Regional Authorities of the Council of Europe për Shqipërinë: “*transferimi i detyrave nga qendrore tek vendore ... nuk ka rezultuar ende në një alokim të qartë të funksioneve midis nivelit qendror dhe atij lokal; bashkitë ende kanë burime financiare të pamjaftueshme*”⁷. Raporti i Komisionit Europian⁸ për Shqipërinë 2015 konstaton se autonomia buxhetore e qeverisjes vendore mbetet e dobët dhe që duhet të punohet për kapacitete administrative.

Dhjetë vite pas reformës territoriale 2015-2025, ndikimi politik dhe elektoral evidentohet në disa elementë:

- **Mungesa e konsensusit dhe votimi njëpartiak⁹**: Reforma u miratua vetëm me votat e shumicës parlamentare, pa marrëveshje të gjerë politike, duke cenuar legjitimitetin politik të saj.
- **Dyshime për gerrymandering**: Kongresi i CoE në Rekomandimin 377¹⁰ (2015) kërkoi hetim të akuzave për manipulim të kufijve zgjedhorë (gerrymandering), duke sinjalizuar nevojë për verifikim të paanshmërisë.
- **Ndikim në sjelljen e votuesve**: Studimi i UNDP mbi edukimin dhe motivimin e votuesve në prag të zgjedhjeve vendore të qershorit 2015 në Shqipëri¹¹ dokumenton ulje motivimi për të votuar në komunitetet e vogla të bashkuara në bashki më të mëdha, me ndjesinë e humbjes së përfaqësimit dhe paqartësi rreth rregullave të reja.
- **Ndikimi në zgjedhjet vendore 2015**: OSBE/ODIHR¹² evidentoi se rikonfigurimi territorial ndikoi kontekstin e garës dhe përfaqësimit; megjithatë, nuk konkludoi për parregullsi sistematike të shkaktuara nga vetë harta.

³ <https://rm.coe.int/168071afe8>

⁴ https://prefektitirane.gov.al/wp-content/uploads/2017/10/Ligj_115-2014_31.07.2014.pdf

⁵ <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2015/12/17/139>

⁶ <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2017/04/27/68-2017>

⁷ <https://rm.coe.int/cg-2021-41-14-en-monitoring-of-the-application-of-the-european-charter/1680a42072?>

⁸ https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/526ea6bb-9a6b-49f8-b4a9-e8d3aae477f5_en?filename=20151110_report_albania.pdf

⁹ <https://www.balkanweb.com/reforma-territoriale-ne-vitin-2014-ishte-miratim-i-njeanshem-deputetja-demokrate-prezanton-raporton-ja-propozimet-e-pd-se/#gsc.tab=0>

¹⁰ <https://rm.coe.int/1680718db0>

¹¹ <https://drive.google.com/file/d/1mKSzBf4eYMO36fNfMMGlR3SXQQmQXdn3/view>

¹² <https://rm.coe.int/168071e80e>

- **Ndarje jo e plotë e kompetencave:** Reforma territoriale në Shqipëri karakterizohet nga mbivendosje funksionesh mes nivelit qendror dhe vendor, paqartësi ligjore dhe kufizim i autonomisë reale të pushtetit lokal, duke penguar zbatimin e plotë të decentralizimit sipas Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore¹³.
- **Kapacitete të pamjaftueshme administrative:** Burimet njerëzore (staf, planifikim, menaxhim financiar) sipas Monitorimit të zbatimit të Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore në Shqipëri vazhdojnë të paraqesin probleme, veçanërisht në autoritetet rurale¹⁴.
- **Varësi e lartë e bashkive nga transfertat qendrore:** Edhe pse bashkive u janë dhënë më shumë kompetenca vendimmarrëse, ato mungojnë në burime financiare dhe kapacitete administrative, ndërsa varësia nga transfertat kombëtare kufizon autonominë fiskale dhe cilësinë e shërbimeve publike¹⁵.
- **Mungesë transparence dhe llogaridhënieje:** Strukturat vendore ende nuk garantojnë mekanizma efektivë të kontrollit, transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare, duke dobësuar llogaridhënien demokratike dhe besueshmërinë e qeverisjes vendore.¹⁶

Pavarësisht nëse kjo reformë ishte politikisht e pavarur, apo u dizajnuar me motive elektorale, në raport me Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore, Shqipëria ka pasur progres. Në planin ligjor, reforma nuk rezulton të ketë qenë e politizuar; por në planin praktik, perceptimi publik dhe indikatorët e riskut sugjerojnë ndikim politik-elektoral. Për të garantuar besim dhe standarde evropiane, kërkohet auditim i pavarur teknik i hartës dhe garanci procedurale në rishikimet e ardhshme në kuadër të Komisionit të Posaçëm 2025¹⁷.

II. Administrata Vendore pas Reformës Territoriale 2015: Autonomi Financiare apo Varësi nga Qendra?

Reforma territoriale një prej objektivave të propozuar nga qeveria qendrore pati uljen e shpenzimeve administrative dhe koston e burimeve njerëzore. Objektivi mund të ishte i dëshirueshëm edhe pse mund të çonte në një reduktim drastik të numrit të punonjësve në 61 bashkitë e reja. Në vitin 2015, në të 65 bashkitë dhe 308 komunat, numri total i punonjësve

¹³ <https://rm.coe.int/cg-2021-41-14-en-monitoring-of-the-application-of-the-european-charter/1680a42072?>

¹⁴ <https://rm.coe.int/cg-2021-41-14-en-monitoring-of-the-application-of-the-european-charter/1680a42072?>

¹⁵ <https://enlargement.ec.europa.eu/system/files/2021-10/Albania-Report-2021.pdf>

¹⁶ <https://rm.coe.int/cg-2021-41-14-en-monitoring-of-the-application-of-the-european-charter/1680a42072?>

¹⁷ <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202510291126114402Procesverbal%2C%20dat%2C%20AB%2016.10.2025.pdf>

ishte 19.625 punonjës, sipas Raportit të Avokatit të Popullit të vitit 2016¹⁸. Po sipas këtij raporti, në vetëm 51 bashki, pas reformës janë larguar në total 3059 punonjës, duke e çuar fillimisht numrin e punonjësve 16.566 persona të punësuar në administratën e pushtetit lokal. Në dukje një fillim i mirë për një nga qëllimet për të cilat u krijua reforma, por më vonë, pati një ndryshim të këtij kursi. Punonjësit e larguar u zëvendësuan nga punonjës të rinj, dhe në vitin 2018, numri i të punësuarve në pushtetin vendor, shkoi në 33.500 punonjës, ndërsa në vitin 2023 arriti në mbi 37.000.


Nëse shohim shpenzimet për personelin dhe bëjmë një krahasim të tremujorit të fundit të vitit 2015 dhe tremujorit të fundit të vitit 2022 (kur janë edhe të dhënat e fundit të përditësuara nga portali i financave vendore publike¹⁹) ndryshimi në 10 vite është i qartë. Sipas të dhënave, kjo rritje ka qenë e përvitshme. Pra çdo vit, numri i punonjësve të administratës në nivele të ndryshme të pushtetit vendor ka ardhur duke u rritur.

Tabela 1_Shpenzimet lokale të shtrira në periudha 2015-2022. Të dhënat janë progresive.

Nga të dhënat e publikuara nga rrjeti investigativ BIRN²⁰, numri i të punësuarve buxhetorë në njësitë e pushtetit vendor arriti në 37

mijë në vitin 2023, me një rritje me 12% kundrejt vitit 2019 dhe me rritje gati 90% në krahasim me vitin 2015. Duke shtuar këtu edhe punonjësit jobuxhetorë, kjo rritje mund të jetë edhe më e madhe se 90%.

Të punësuarit e sektorit publik në Shqipëri ndahen në “buxhetorë” dhe “jobuxhetorë”, ku në kategorinë e parë janë të punësuarit, paga e të cilëve mbulohet nga taksat që paguajnë qytetarët ndërsa në sektorin “jobuxhetorë” përfshihen të punësuarit në kompanitë nën pronësinë publike, të cilët i marrin rrogat nga pagesat e qytetarëve dhe bizneseve në shkëmbim të shërbimeve apo mallrave të shitura nga këto kompani. Ndarja gjithsesi nuk është e prerë sepse shumë nga kompanitë nën pronësi publike shpesh janë me humbje dhe



¹⁸ <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/RAPORTI%202016.pdf>

¹⁹ <http://financatvendore.al/>

²⁰ <https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2023/07/Zgjedhjet-e-pushtetit-vendor-2023-ne-Shqiperi-Perfaqesimi-i-grave-ne-median-digjitale.pdf>

subvencionohen nga buxhetet që paguhen përmes sistemit të taksimit. Kështu p.sh., kompanitë e futbollit janë në masë të subvencionuara nga buxhetet bashkiake pavarësisht se në teori janë kompani më vete e po kështu, ndërmarrjet e ujësjellësve marrin subvencionime, të cilat, teorikisht duhet të shërbejnë për të kryer investimet e nevojshme për furnizim me ujë pavarësisht se praktikisht përfundojnë për të paguar stafe të fryra. Rritja e stafeve të Bashkive, pasqyrohet qartë edhe në bilancet e shpenzimeve të bashkive për personel, siç i paraqet grafika më poshtë:




Tabela 2_Shpenzimet lokale të shtrira në periudha 2010-2015. Të dhënat janë progresive.


Por nëse bëjmë një krahasim edhe më herët, dhe shohim ecurinë e shpenzimeve të njësjive të vetëqeverisjes vendore për personelin, shohim që deri në momentin e miratimit të reformës, ishin pak a shumë të njëjtat shpenzime konstante për 5 vitet e fundit, pra 2010-2015. Por nëse i krahasojmë më atë që ndodhi pas reformës, rritja është e përvitshme, dhe grafiku ka vetëm rritje.

Por le të bëjmë edhe një krahasim mes të ardhurave, dhe shpenzimeve, dhe veçanërisht shpenzimeve për personelin. Për të plotësuar kërkesën e vazhdueshme për të ardhura në mënyrë që të rrisin numrin e punonjësve siç e kemi parë deri tani, Njësitë e vetëqeverisjes vendore, kanë patur nevojë për më shumë para. Nëse i hedhim një sy grafikut të rritjes së numrit të punonjësve dhe grafikut të rritjes së taksave dhe tarifave vendore, shohim që kurba është pak a shumë e njëjtë. Sa më shumë rriten stafet, aq më shumë rriten taksat dhe tarifat vendore. Kjo tregon edhe njëherë se ata të cilët janë duke përballuar rritjen e numrit të punonjësve, janë vetë qytetarët.

Interesant është edhe kahasiimi që mund të bëjmë me para dhe pas reformës: Nëse para reformes, kurba e rritjes së numrit të të punësuarve ishte pak a shumë konstante, e njëjtë është edhe kurba e rritjes së taksave dhe tarifave vendore.

Pas 2015, kur kurba e të punësuarve pëson një rritje vit pas viti, me të njëjtin ritëm rritet edhe kurba e rritjes së taksave dhe tarifave vendore.

Tabela 3_ Të ardhurat nga tarifat vendore për vitin 2023



Rritja dramatike e numrit të punonjësve në pushtetin vendor përgjatë dekadës së fundit vjen në një kohë kur popullsia faktike e pranishme në territorin e pothuajse të gjitha bashkive ka rënë, gjë që nënkupton nevojën për më pak punëtorë për të kryer shërbimet përkundrejt popullsisë së mbetur. Arsyeja kryesore e reformës së vitit 2015 ishte që, përmes reduktimit të njësive të qeverisjes vendore nga 394 në 61, të mund të ulëshin kostot administrative dhe të çliroheshin fonde në dispozicion të investimeve për rrugë, ujësjellës apo kanalizime, apo për të krijuar sistemin e grumbullimit dhe përpunimit të mbeturinave, funksione këto kyçe të pushtetit vendor.

Mandati 2019-2023 u krijua pas refuzimit të opozitës kryesore për të marrë pjesë në zgjedhjet e vitit 2019, gjë që bëri që socialistët të kontrollonin jo vetëm kryetarët e bashkive por edhe shumicat dërrmuese të këshillave bashkiak. Përgjatë këtij mandati, numri i të punësuarve në pushtetin vendor u rrit nga 33 mijë në 37 mijë ose me 13%. Në 50 nga 61 bashkitë e vendit mandati u shoqërua me rritje të numrit të të punësuarve, ndërkohë që supozohet se pushteti vendor ka nevojë të rrisë investimet për shërbimet publike bazë, ujësjellës, kanalizime, rrugë rurale apo pastrim e gjelbërim.

III. Struktura Territoriale e Shqipërisë: Ndarje Rajonale apo Qendër e Përqendruar?

Struktura territoriale e Shqipërisë përcaktohet kryesisht nga Ligji nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative dhe territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, i mbështetur nga Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Në nivel strategjik, qeveria shqiptare ka miratuar Ligjin nr. 102/2020 “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin²¹”, i cili synon të përafrojë politikat kombëtare me Politikën e Kohezionit të Bashkimit Evropian. Ky ligj parashikon krijimin e një Sistemi Kombëtar për Zhvillim Rajonal, i ndarë në katër zona të klasifikimit NUTS (*Nomenclature of Territorial Units for Statistics*):

²¹<https://qeverisjavendore.gov.al/wp-content/uploads/2024/08/Ligji-nr.-102-date-29.7.2020-Per-zhvillimin-rajonal-dhe-kohezionin.pdf?>

- **NUTS 1:** Shqipëria konsiderohet si një rajon i vetëm;
- **NUTS 2:** Përdoret për politikat e kohezionit, dhe Shqipëria ka ndarë territorin në katër rajone zhvillimore (Rajoni Veri përfshin qarqet: Shkodër, Kukës, Lezhë; Rajoni Qendër përfshin qarqet: Durrës, Tiranë, Elbasan, Dibër, Rajoni Jug-Lindje përfshin qarqet: Korçë, Pogradec, Devoll, Kolonjë, Rajoni Jug-Perëndim përfshin qarqet: Vlorë, Fier, Berat, Gjirokastër, Sarandë)
- **NUTS 3:** Përfshin 12 qarqet (prefekturat) ekzistuese, që janë nivele më të vogla për analiza më të detajuara.

Në nivel evropian, politikat rajonale dhe të kohezionit bazohen në parimin e subsidiaritetit dhe të partneritetit shumënivëlësh. Kjo do të thotë se çdo rajon duhet të ketë kompetenca të qarta ligjore, kapacitete financiare dhe institucione të zgjedhura që menaxhojnë fondet publike dhe fondet e BE-së në nivel rajonal.

Në Shqipëri, pavarësisht realizimit të reformës territoriale 2015, centralizimi i funksioneve dhe burimeve financiare ka mbetur problem thelbësor. Qarqet nuk kanë autonomi buxhetore, nuk kanë organe të zgjedhura, dhe veprojnë më shumë si “zyra territoriale” të qeverisë qendrore sesa si institucione përfaqësuese të zhvillimit rajonal. Për pasojë, edhe pse kuadri ligjor (ligji për zhvillimin rajonal) është formalisht i përafuar me standardet e BE-së, mungesa e kapaciteteve institucionale dhe financiare e pengon Shqipërinë të aplikojë mekanizmat e qeverisjes shumënivëlëshe (*multi-level governance*), të cilët janë thelbësorë për integrimin efektiv në BE.

Kjo situatë ka sjellë:

- **Mungesë të qartë koordinimi ndërmjet nivelit vendor dhe atij qendror** në planifikim dhe menaxhim fondesh;
- **Përqendrim të investimeve publike në Tiranë dhe zonat urbane kryesore**, në dëm të balancës territoriale;
- **Vështirësi në krijimin e “strukturave menaxhuese rajonale”**, të cilat janë të nevojshme për përdorimin direkt të fondeve IPA dhe të fondeve strukturore të BE-së.

Në prag të Reformës Administrative Territoriale, dilema aktuale qëndron midis konsolidimit të ndarjes ekzistuese me 61 bashki dhe 12 qarqe, apo krijimit të një niveli të ri rajonal me kompetenca të plota zhvillimore. Në praktikë, Shqipëria është një shtet me administrim të centralizuar, ndërsa Politikat e Bashkimit Evropian për zhvillim territorial dhe kohezion synojnë reduktimin e pabarazive ndërmjet rajoneve dhe fuqizimin e rajoneve funksionale në kuadër të Politikës së Kohezionit 2021-2027²² inkurajojnë forcimin e niveleve rajonale si

²² https://ec.europa.eu/regional_policy/2021-2027_en?

instrument për zhvillim të balancuar dhe menaxhim efektiv të fondeve. Reforma Administrativo-Territoriale e vitit 2015 u fokusua kryesisht në rritjen e eficiencës administrative dhe ofrimin e shërbimeve publike në nivel vendor, pa adresuar në mënyrë të plotë dimensionin e zhvillimit ekonomik rajonal. Si rezultat, janë evidentuar një sërë sfidash strukturore që justifikojnë nevojën për një Reformë Territoriale duhet të adresojë: fragmentimit institucional ndërmjet bashkive dhe qarqeve; mungesës së planeve funksionale të zhvillimit rajonal; përqendrimit të burimeve financiare dhe vendimmarrëse në nivel qendror; mospërputhjes së strukturës aktuale territoriale me praktikën evropiane të planifikimit rajonal, përfshirë përdorimin e klasifikimit NUTS për qëllime zhvillimore dhe statistike²³.

Përafrimi gradual me standardet dhe praktikën e BE-së në fushën e zhvillimit rajonal, përfshirë referencën ndaj nivelit NUTS 2, nënkupton nevojën për krijimin e rajoneve funksionale të zhvillimit, të afta për të planifikuar, koordinuar dhe zbatuar politika ekonomike territoriale, në përputhje me qasjen e promovuar në kuadër të procesit të zgjerimit të Bashkimit Evropian²⁴. Një rikonceptim i tillë kërkon:

- një bazë të re ligjore që garanton status juridik dhe kompetenca funksionale për rajonet;
- burime financiare të qëndrueshme dhe instrumente buxhetore rajonale;
- struktura përfaqësuese dhe mekanizma vendimmarrjeje në nivel rajonal; kapacitete institucionale për menaxhimin e fondeve të zhvillimit dhe programeve të BE-së.

Nëse Shqipëria synon integrim të plotë në BE, reforma territoriale duhet të kalojë nga “bashkim bashkish” në krijim të rajoneve funksionale zhvillimore. Vetëm përmes decentralizimit real dhe krijimit të rajoneve të vetëqeverisura, mund të arrihet autonomi financiare, zhvillim territorial i balancuar dhe zbatim efektiv i parimit të subsidiaritetit, në përputhje me modelin evropian të qeverisjes shumë-nivelëshe.

Objekti	Shqipëri	Bashkimi Evropian	Vlerësim/Kritikë
Struktura territoriale	1 shtet unitar; 61 bashki + 12 qarqe; 4 rajone zhvillimi ligjore (pa kompetenca autonome)	Sistemi NUTS: NUTS 1 (shtet), NUTS 2 (rajon zhvillimi me kompetenca dhe buxhet), NUTS 3 (njësi vendore)	Shqipëria ka nivel bashkiak funksional, por nuk ka rajone me kompetenca të pavarura , ndonëse raporton në NUTS 2 për Eurostat
Autonomi dhe	Bashkitë kanë kompetenca të	Rajonet NUTS 2 kanë kompetenca të qarta për	Shqipëria mbetet centralizuese , nuk ka

²³ <https://ec.europa.eu/eurostat/web/nuts?>

²⁴ https://enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/strategy-and-reports_en?

funksi	kufizuara; qarqet vetëm koordinojnë; rajonet e zhvillimit nuk kanë pushtet legjislativ ose buxhetor	zhvillim ekonomik, menaxhim fondesh strukturore dhe kohezioni, plane zhvillimi rajonal	implementuar subsidiaritetin e BE-së në nivel rajonal
Financa dhe burime	Bashkitë varen kryesisht nga transfertat qendrore; rritja e stafit ka rritur shpenzimet për personel; fonde rajonale të BE-së nuk menaxhohen direkt	Rajonet kanë buxhete autonome, mund të menaxhojnë fondet e BE-së (strukturnale, kohezioni) dhe të kombinojnë burime lokale	Varësia e bashkive nga qendra dhe mungesa e buxheteve rajonale pengon përdorimin efektiv të fondeve të BE-së
Përfaqësim dhe demokraci vendore	Bashkitë zgjedhin kryetar dhe këshill; qarqet dhe rajonet nuk kanë asamble zgjedhore	Rajonet NUTS 2 shpesh kanë asamble ose mekanizma për përfaqësim rajonal	Shqipëria nuk ka pjesëmarrje qytetare në nivel rajonal , që kufizon llogaridhënien dhe transparencën
Përafrimi me BE	Raporton në NUTS 2 për Eurostat; nuk ka rajone autonome	Rajonet NUTS me kompetenca reale dhe fonde	Përputhja me BE është formale/statistike , jo operative

Tabela 4_Shqipëria dhe BE: Sfida dhe Përputhshmëri në Ndarjen Territoriale dhe Financat

IV. Rekomandime politike dhe institucionale për Reformën 2.0 dhe përputhshmërinë me standardet e BE-së

Rekomandimet kryesore (strategjike):

- I. Rishikimi i ndarjes territoriale dhe forcimi i nivelit rajonal në përputhje me standardet NUTS të BE-së.
- II. Rritja e autonomisë financiare të bashkive përmes burimeve të reja fiskale dhe ndarjes më të drejtë të fondeve qendrore.
- III. Vendosja e mekanizmave të pjesëmarrjes qytetare (referendume lokale, buxhetim pjesëmarrës, forume komunitare).
- IV. Depolitizimi dhe profesionalizimi i administratës vendore.
- V. Digjitalizimi i qeverisjes vendore për transparencë dhe llogaridhënie.
- VI. Hartimi i një strategjie kombëtare për qeverisjen vendore 2025–2030 të harmonizuar me Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore.

Rekomandimet të detajuara / dytësore (operacionale):

- I. **Auditim i pavarur teknik i hartës territoriale 2015 & Matje e ndikimit elektoral:** Verifikim i neutralitetit dhe proporcionalitetit; përgjegjës Komisioni i Posaçëm Parlamentar (2025), CoE, OSBE dhe ekspertë ndërkombëtarë.
- II. **Rregull “No Reform Before Elections” (12 muaj para):** Ulja e dyshimeve për manipulim elektoral; përgjegjës Kuvendi i Shqipërisë, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve dhe Shoqëria Civile.
- III. **Publikimi i metodologjisë së Reformës 2.0 & Konsultime publike të detyrueshme në çdo bashki:** Transparencë, besim publik dhe legjitimitet demokratik; përgjegjës Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Komisioni i Posaçëm Parlamentar.
- IV. **Forcim i autonomisë fiskale vendore & Balanca urban-rural në financim dhe shërbime:** Ulje e varësisë nga qendra dhe parandalim i pabarazisë territoriale; përgjegjës Ministria e Financave, Bashkitë, Komisioni i Posaçëm Parlamentar dhe Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor.
- V. **Modele pilot bashkëpunimi ndërbashkiak:** Efikasitet në shërbime dhe shmangie e fragmentimit; përgjegjës Qeveria me asistencë donatorësh.
- VI. **Indeks kombëtar i pavarësisë vendore & Observator i paanshmërisë së reformës:** Monitorim i ndikimit politik dhe mbikëqyrje teknike e procesit; përgjegjës Këshilli i Europës, INSTAT, CoE, OSBE/ODIHR dhe Shoqëria Civile.
- VII. **Krijimi i rajoneve funksionale zhvillimore me status juridik të qartë:** Secili rajon duhet të ketë ligj themelor që garanton kompetenca legjislative dhe ekzekutive të kufizuara, duke përfshirë plane zhvillimi ekonomik dhe menaxhim të fondeve.
- VIII. **Vendosja e organeve të zgjedhura rajonale:** Krijimi i këshillave ose bordeve rajonale të zgjedhura, që përfaqësojnë qytetarët dhe garanton pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje, në përputhje me parimin e subsidiaritetit të BE-së.
- IX. **Buxhete autonome rajonale dhe menaxhim fondesh BE:** Rajonet duhet të kenë burime financiare të garantuara dhe mundësinë për të menaxhuar fonde strukturore dhe IPA për të stimuluar zhvillimin e balancuar.
- X. **Planifikim rajonal dhe koordinim me bashkitë:** Zbatimi i planeve të zhvillimit rajonal të integruara me bashkitë dhe qarkun për të përmirësuar efikasitetin dhe koordinimin e investimeve publike.
- XI. **Indikatorë dhe monitorim i performancës rajonale:** Krijimi i indeksit rajonal të zhvillimit dhe pavarësisë për të vlerësuar ndikimin e politikave rajonale; përgjegjës INSTAT dhe institucionet ndërkombëtare (CoE/OSBE).
- XII. **Projekte pilot për bashkëpunim ndër-rajonal:** Zbatimi i modeleve pilot për bashkëpunim midis rajoneve, në fushat e shërbimeve publike dhe investimeve, për të shmangur fragmentimin dhe për të rritur efikasitetin.
- XIII. **Transparencë dhe komunikim publik:** Rajonet duhet të publikojnë raporte vjetore mbi performancën, shpenzimet dhe projektet e zhvillimit, për të rritur besimin dhe llogaridhënien.